



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:153536

Datë: 24.02.2021

Numri i dokumentit: 01534249

PKR.nr.1029/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Naser Foniqi, me sekretaren juridike Sevdije Breznica, si procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit E.Sh., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366, par. 1, të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Përgjithshëm **PP.I.nr.478/2020**, të datës **09.11.2020**, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 23.02.2021, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i shtetit **Bashkim Zeqaj** dhe i akuzuari E.Sh., të njëjtën ditë, me datë 23.02.2021, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari E.Sh., i biri i A. dhe S., e vajzërisë B., i lindur me datë ... në Prishtinë, me banim në fshatin ..., Komuna ..., Lagja "...", me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar-baba i 3 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: me datë 19.02.2020, rreth orës 16:34, në fshatin ..., lagjja ..., Komuna Obiliq, gjatë kontrollit nga ana e policisë, të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse, pronë e të akuzuarit, është gjetur një karikator AK-47, të cilin si pjesë përbërëse të armës e ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim pa autorizim dhe në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-022 Për Armët, e pastaj i njëjti i është sekuestruar nga policia,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366, par. 1, të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 46, par. 1, nënpar. 1.1; 47; 48; 69 dhe 366, par. 1 dhe 3, të KPRK, si dhe nenit 365, të KPPK, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT ME GJOBË

- **Në shumë prej katërqind (400) €**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se brenda afatit prej **një (1) viti**, i akuzuari nuk do të kryej veprë të re penale.

- Obligohet i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, **ndërsa në emër të paushallit gjyqësor duhet të paguaj shumën prej tridhjetë (30) €**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- **Të akuzuarit i konfiskohet një karikator AK-47**, i cili është si rezultat i kryerjes së veprës penale.

ARSYETIMI

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës/Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë nr.2020-AJ-0061, të datës 28.08.2020, Prokuroria Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën **PP.I.nr.60/2020**, të datës **12.03.2020**, ka akuzuar të pandehurin **E.Sh.**, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366, par. 1, të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 23.02.2021, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari **E.Sh.**, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, si dhe ka shtuar se është i vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit dhe se i vjen keq që arma i është gjetur pa leje, pasta, i akuzuari ka thënë se të njëjtën e ka gjetur afër një shtëpie, përkatësisht në rrugë dhe kjo ka ndodhur rreth një javë para se të ndalohej nga policia, duke shtuar se të njëjtin (karikatorin) nuk e ka fshehur por e ka mbajtur në shtëpi dhe gjatë kontrollit e ka gjetur policia. Po ashtu, i akuzuari ka thënë se karikatorin të cilin prokuroria e ka cilësuar si armë, ka qenë i zbrazët dhe në fund të fjalës së tij ka kërkuar nga gjykata një dënim më të butë, duke pasur parasysh se ai tani nuk është duke punuar dhe se atë, bashkëshorten dhe tre fëmijët e tij prej 2 -10 vjeç, i ndihmon babai dhe tre vëllezërit e tij, me të cilët është i ndarë.

Sa i përket pranimin të fajësisë nga i akuzuari, prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi konsideron se pranimi i fajësisë është bërë konfirm dispozitave në nenin 248, të KPPK dhe në përputhshmëri të plotë me provat dhe faktet që gjenden në shkresat e lëndës me të cilat vërtetohet kryerja e veprës penale dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet në bazë të KPRK.

Pas deklarimit të akuzuarit **E.Sh.**, se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga prokuroria, trupi gjykues me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, si dhe u mbështet në faktet që përmban aktakuza, e cila nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës përkatësisht: deklarata e dëshmitarit **M.Sh.**, dhënë në polici me datë 19.02.2020; deklarata e të akuzuarit **E.Sh.**, dhënë në polici me datë 27.08.2020; procesverbali mbi bastisjen e banesës i datës 04.10.2019; vërtetimi mbi sekuestrimi e sendeve nr.2020-AJ-0061, të datës 28.08.2020 dhe foto albumi në të cilin shihet pjesa e armës e sekuestruar, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtorë të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori

në konsideratë rrethanat lehtësuese si: sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar; rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, përkatësisht nuk ka palë të dëmtuar; pranimin e fajit për veprën e kryer penale, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38, të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Sa i përket vendimit mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, i njëjti u mor në bazë të nenit 453, par. 4, të KPPK, pasi që pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe personave që ai detyrohet t'i mbështes materialisht, përkatësisht bashkëshortes dhe katër fëmijëve të tij, pasi i akuzuari ka të hyra 170 euro me të cilat mban familjen e tij gjashtë anëtarëshe.

Vendimi që të pandehurit t'i konfiskohet sendi i përdorur për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të nenit 366, par. 3, të KPRK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve 366, par. 1 dhe 3, të KPRK, si dhe nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 25.02.2021.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.1029/2020, datë 23.02.2021.

Sekretare juridike,
Sevdije Breznica

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.